



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Datë: 22.07.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli Bashkaik Kamëz i mbledhur sot, në dt. 22.07.2026, në orën 16:00, në mbledhjen e radhës të muajit Korrik 2026 në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 24 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshilli Bashkiak z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Kr. Hysen Koldashi: Përshëndetje. Ju faleminderit që jeni prezent në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Korrik. Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit Bashkiak 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak.

Kr. Hysen Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.

Kr. Hysen Koldashi:Paraprakisht hedhim në votim proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. E hedhim në votim. 23 vota-Pro, 0 vota -Kundra, 0 vota -Abstenim.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:

1. *Projekt-Vendim për: “Dhënie e ndihmës financiare për diegie banese”.*
2. *Projekt-Vendim për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.*
3. *Projekt-Vendim për: “Mbështetjen financiare të shoqatës sportive “Maraton Albania” për realizimin e turneut ndërkombëtar, “ Kamza Marathon 2026”.*
4. *Projekt-Vendim për: “Emërtimin e stadiumit “Kamza Arena” në Lagjen Administrative Nr.1”.*

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S’ka. E hedhim në votim rendin e ditës. 23-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë vazhdojmë me radhë me projektvendimet sipas rendit të ditës. Projektvendim nr. 46 datë 15.07.2026 për: Dhënie e ndihmës financiare për djegie banese. Këshilltarët, ka ndonjë pyetje, ndonjë paqartësi për drejtorinë përkatëse? Ka kush pyetje? Pa qartësi për projektvendimin që sapo lexuam? Nuk ka.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ



Kr. Hysen Koldashi: E hedhim në votim rendin e ditës. 23-Pro; 0-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Projektvendim numër 47 datë 20.07.2026 për: Dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike. Këshilltarë, kemi pyetje? Ndonjë paqartësi nga këshilltarët? Po, i nderuar, fjala për ju.

N/kr Kësh Bashkiak z.Munir Shehu merr fjalën: Përshëndetje. Një natë më parë duke kaluar rrugës kam parë duke fletur në një makinë te Fafa një individ të cilit vetëm emrin e kam marrë e kishte (.....) dhe sipas informacionit që kam marrë, nuk e di as emrin e babait, as se di se ku e ka familjarët. Shpesh ky person është parë edhe në rrugët e zonës së Bathores. Kërkoj nga zyra e Ndihmës Ekonomike dhe Strehimit të interesohen për ti ardhur në ndihmë. Jam sinqerisht i shokuar.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë faleminderit për sugjerimin tuaj. Sekretaria, me shkresë konkrete dhe me propozimin e këshilltarit, t'ia drejtojë drejtorisë përkatëse, të cilët mbulojnë këtë shtresë, të interesohen, ta verifikojnë, dhe nëse... nëse ligjërisht i bie që të trajtohet sipas ligjit, duhen të ndjekin hapat e duhura, nëse jo, pastaj është pjesë tjetër.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, Këshilltar, ka pyetje të tjera? Diskutime, pa qartësi? Nuk ka! E hedhim në votim. 23-Pro 0- Kundra 0- Abstenim, Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Kalojmë tek projektvendimi tjetër. Projektvendim numër 48 datë 27.07.2026 për: Mbështetjen financiare të shoqatës sportive "Maratonë Albania" për realizimin e turnet ndërkombëtar "Kamza Maratonë" 2026. Do t'ia japim fjalën drejtorit apo përfaqësuesit të drejtorisë të na e shpjegojë. Ju lutem, shumë... ne e kemi relacionin shpjegues, por për diçka që nuk e ka shumë, do të na e thoni shumë shkurt edhe konçisht. Fjala për ju.

Luftar Kurti Përgjegjës i Sektori i Sportit. Përshëndetje, të nderuar këshilltarë, i nderuar kryetar. Në bazë të kalendarit vjetor të aktiviteteve sportive, Bashkia Kamëz, në bashkëpunim me shoqatën sportive "Maratonë Albania", tek Parku i Liqenit në datë 25 dhe 26 shtator 2026, do të organizojë turneun ndërkombëtar "Kamza Maratonë". Në këtë pjesëmarrje planifikohet të marrin rreth 1100 sportistë të moshave 12 deri 18 vjeç, dhe rreth 500 sportistë profesionistë dhe amatorë. Nga ky aktivitet, nga buxheti i Bashkisë Kamëz do të mbulohen kupa, medalje për sportistët, bluza me çip, antenna për monitorimin e sportistëve gjatë garës, gjyqtarë, stafi mbështetës, edhe personeli mjekësor. Ndërsa furnizimi me ujë të pijshëm i stafit dhe sportistëve, dekorimi i start-finishit dhe i gjithë parkut të liqenit, podiumi, monitori LED 8 metra herë 4,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**



akomodimi i stafit drejtues dhe të ftuarve që vijnë nga jashtë Shqipërisë, do të kryhet nga shoqata sportive dhe donatorë të ndryshëm që e mbështesin këtë aktivitet.

Mbledhjes i bashkohet antaria e Këshillit znj. Zamira Jata

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, Këshilltar, ka pyetje të tjera? Diskutime, pa qartësi? Nuk ka! E hedhim në votim. 23-Pro 0- Kundra 1- Abstenim, Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë kemi projektvendim nr.44 datë 23.06.2026. Do bëj një shpjegim paraprak. Në mbledhjen paraardhëse të Këshillit Bashkiak, kemi kaluar, në mos gabo, 5 apo 6 segmente rrugësh për emërtime, bashkë me të, kemi kaluar edhe stadiumin "Kamza Arena" për emërtim, të cilat, në momentin kur kemi filluar votimin për këta emërtime rrugësh, sekretaria më ka njoftuar që këshilltarë janë larguar nga mbledhja dhe unë s'isha i vëmendshëm, ndoshta, dhe i kemi kaluar, por ato projektvendime janë nul, nuk janë kthyer në vendime. Emërtimi i stadiumit duhet të kalojë më shpejt për arsye objektive. Kurse rrugët, do t'i kalojnë edhe një herë në Këshillin Bashkiak. Pra, janë për mungesë të korrumit të Këshillit Bashkiak të mbledhjes paraardhëse. Janë larguar 2 këshilltarë dhe kanë lënë numrin më poshtë se 21. Sot risjellim për emërtim stadiumin "Kamza Arena" në Lagjen Administrative nr. 1 në Valias. Ka kush pyetje? Ndonjë diçka? E kemi kaluar gjithsesi, do të... jam i detyruar të kaloj edhe unë.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, Këshilltar, ka pyetje të tjera? Diskutime, pa qartësi? Nuk ka! E hedhim në votim emërtimin e stadiumit 24-Pro 0- Kundra 0- Abstenim, Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Kështu që, duke ju falënderuar të gjithëve juve për kontributin tuaj, me votën tuaj, kalojmë projektvendimet në vendime.

Kr. Hysen Koldashi: Kalojmë tek pika tjetër, të ndryshme. Kush e do fjalën? Po, znj. Prenga.

Merita Prenga Këshilltare: Faleminderit. Atëherë, meqenëse në çdo institucion Bashkia Kamëz, i ka marrë parasysh se si mund të realizohet më mirë qëndrimi i personelit mësitor, kryesisht mjetet e tyre, pra të transportit, makinat, edhe në shkollën në të cilën unë e drejtoj, kërkoj që të vendoset aty parkim vetëm për institucionin, pasi ka shumë probleme në mëngjes, krijohen probleme nga prindërit, nga banorët, nga mësuesit. Që të mos jenë këto probleme, kërkoj që edhe në institucionin tonë të vendoset një tabelë.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit. Sekretaria mban shënim dhe me shkresë zyrtare i drejtohet Drejtorisë së Transporteve dhe Shërbimeve Publike dhe ata shikojnë nëse është e mundur. Nëse është e mundur, pse mos të bëhet edhe ajo gjë.

Kr. Hysen Koldashi: Këshilltar shqetësime të tjera? Po z. Shehu fjala për ju.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Munir Shehu N/kr Kësh Bashkiak merr fjalën: Në fillim të mbledhjes, ne miratuam rendin e ditës, por para rendit të ditës miratuam procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Dhe në procesverbalin e mbledhjes së kaluar, ato projektvendimet e rrugëve, siç the ti, nuk janë të pasqyruar. Ne i kemi votuar njëherë ato rrugë dhe për këtë arsye duhet të ishin thënë që në momentin e parë. Ju thatë që nuk ka qenë koorumi. Në qoftë se nuk ka qenë korrumi, nuk duhet të vazhdonte mbledhja, z. kryetar

Kr. Hysen Koldashi: E sqaroj, Atëherë, i dashur kolegu im më i afërt nënkryetar i Këshillit Bashkiak, doktor profesor Munir Shehu, unë e sqaroja krejt saktë. Në momentin, pra, sekretaria më ka njoftuar se nuk është kourumi, unë kam qenë i pavëmendshmë, e kam kapur me vonesë. Ka qenë mbledhja nul nga momenti kur ka patur mungesë kourumi. Dhe ato projektvendime të cilat janë në mungesë të kourumit, janë nul dhe do të rikthehen për t'u votuar në Këshillin Bashkiak. Stadiumi duhet shpejt, kurse rrugët presin. Këshilltar tjetër, diçka? Po I nderuar.

Nazif Sulaj Këshilltar: Faleminderit, zoti kryetar. Doja të ngre një shqetësim: në qoftë se adresohet te ndërmarrja e UKK për furnizimin me ujë të zonave të ndryshme, por veçanërisht zonës së Bathores, Lagja Nr.5, bëhet një furnizim me ujë jashtëzakonisht me orare shumë të reduktuara dhe në orare shumë të vona të natës. Që do të thotë, mbas orës 1-2 të natës, që besoj se të gjithë janë në gjumë dhe nuk arrijnë të marrin ujë.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë, faleminderit. Jam shumë i qartë dhe jam dijeni të kësaj gjëje se kam patur shqetësime direkte nga qytetarët. Dhe ajo zona, Lagja 5 Bathore, ka qenë në rikonstruksion të disa tubacioneve. Unë kam biseduar edhe me drejtorin personalisht, e kam pasur këtë shënim edhe personalisht në mesazh, dhe kam biseduar edhe me drejtorin e përgjithshëm, edhe me drejtorin e zyrës së përgjegjës të Bathorës, dhe më ka njoftuar se po bëhej rikonstruksion në disa zona të kësaj lagjeje.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë, kush ka një propozim, kishte një propozim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak të ardhshëm ta zhvillojmë online. Po, znj Çipa?

Jamdiella Cipa Këshilltare: Përshëndetje. Propozoj që mbledhja e Këshillit Bashkiak e muajit të ardhshëm të bëhet online, për arsye të pushimeve që mund të ketë secili nga neve në muajin Gusht.

Kr. Hysen Koldashi: Tani, propozimi është që mbledhja e muajit gusht, edhe në traditën tonë, ka qenë pothuajse... jo gjithmonë, por pothuajse në shumicën e rasteve, muaji Gusht është bërë online. Mirëpo, këtë tagër e ka vetëm Këshilli Bashkiak.. Nëse vendosim me votë që mbledhjen



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

mund ta bëjmë edhe në Zoom, pra online, ok. Nëse nuk miratohet, atëherë jam i detyruar ta hedhim votim.

Faik Basha Këshilltar merr fjalën: Rregullorja e parashikon që mbledhjet e këshillit mund të bëhen online vetëm në raste emergjente.

Kr. Hysen Koldashi: Është shumë e saktë. Pra, vetëm në raste të veçanta. Edhe ky futet te rastet e veçanta. Sa është? A është rast krejt i veçantë se muaji gusht administrata është pushim? Ne kemi marrë... ne kemi marrë votëbesimin e qytetarëve për të ardhur edhe muajin gusht. E hedhim votim. Nëse miratohet, ok. Nëse jo, bie poshtë.

Munir Shehu Nkr: Jemi dakord nëse kalojmë vetëm ndihmat ekonomike.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, Këshilltar, ka pyetje të tjera? Diskutime, pa qartësi? Nuk ka! E hedhim në votim. 23-Pro 1- Kundra 0- Abstenim, Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë, ne e miratuam që edhe mund ta bëjmë. Jo "do ta bëjmë". Pra, edhe mund ta bëjmë. Do jemi në kontakt. Nëse mund të realizohet, do komunikojë sekretaria e parë me gjithë këshilltarët. Nëse mund të bëjmë, edhe mund ta bëjmë. Pra, edhe, edhe i bie. Dakord? Atëherë, ka kush diçka tjetër? Nuk ka.

Kr. Hysen Koldashi: Ju falënderoj për prezencën. Uroj pushime të qeta, të freskëta, të mira, të gëzueshme për gjithsecilin. Dhe miru takoheshim muajin tjetër, ose muajin shtator.

SEKRETAR

Nexhmije TOPI